



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 48 / 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 11.01.2011, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

## A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 09.01.2011, nga subjekti politik LVV, me te cilën pretendohet se më datë 09.01.2011 në ora 18:45, Afrim Balaj zyrtar i AAK-së zëvendës drejtor i shkollës fillore “Lidhja e Prizrenit” në fshatin Carabreg komuna e Deçanit, ka votuar për herë të dytë në Qendrën e Votimit 0101X Vendvotimi 01 në shkollën fillore “Lidhja e Prizrenit”. Sipas parashtresës të ankesës i lartpërmenduri është votues në Qendrën e Votimit 0101C në gjimnazin “Vëllezërit Frashëri” në Deçan 01R ku se pari ka votuar në këtë qendër. Më këtë parashtresë i ankesës konsideron se është bërë shkelje e nenit 91.2 i LZP-së dhe nenit 178 të KPK-së.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

**- ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se pretendimet nga parashtruesi i ankesës se janë bërë shkeljet e potencuar në ankesë janë të pabazuara nga shkakut se nuk janë ofruar dëshmi për të besuar se kanë ndodhur shkelja e tillë. Për më tepër, parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur një deklaratë eventuale nga dëshmitari/komisioneri i lartcekur. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 48/2011 më datën 11.01.2011

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**

